

**PAKETA
LEHTËSUESE PËR
INDUSTRINË E REGJIMIT
TË PËRPUNIMIT AKTIV
(FASON)**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES**

Hapat e ndjekur

- » U ngrit Grupi i Punës në Ministrine e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me përfaqësues të biznesit fason dhe institucioneve përgjegjëse;
- » U konsultuan propozimet e industrisë dhe u hartua matrica paraprake e masave lehtësuese;
- » U shqyrtuan dhe u diskutuan propozimet me institucionet përgjegjëse për planin e veprimit;
- » U zhvilluan vizita në disa biznese fason për të diskutuar ecurinë e hartimit të paketës;
- » U finalizua Paketa e plotë mbështetëse duke marrë si referencë 46 propozimet e industrisë së fasonit.

Performanca e sektorit

Problemet kryesore

1- Eksporte dhe vlera eksportesh të ulta:

Vlerat e eksportit në këtë sektor¹ (si % e totalit të eksporteve në Shqipëri) janë në rënie: nga 47.72% (2009) në 29.45% (2013)²;

Eksportet për frymë për Shqipërinë janë në vlerën e rreth €183.76 (2013), ndërkohë që vende të rajonit si Maqedonia apo Kroacia kanë një nivel më të lartë të eksporteve për frymë, përkatësisht: Maqedonia € 285.85 (2011), Kroacia € 238.48 (2012).

2- Mundësi më të mëdha për prodhim, eksport dhe punësim.

¹ Degët e tekstilit, lëkura dhe këpucët, janë të përfshira

² Burimi: INSTAT


► Përmirësimi i eksporteve

- Viti i I: nga 495 në 590 mln Euro
- Viti i II: nga 590 në 720 mln Euro
- Viti i III: deri në 900 mln Euro

► Rritja e punësimit

- Viti i I: nga 28,058 në 43,000
- Viti i II: nga 43,000 në 68,000
- Viti i III: deri në 100,000

Vlera e eksporteve për sektorin (mln Euro)



Niveli i punësimit në sektor



Propozimet e Biznesit

1. Ulje e çmimit të tokës dhe qirasë së mjediseve të biznesit, për investimet ekzistuese dhe ato të reja
2. Thjeshtim i procedurave të import-eksportit për produktet kompensuese dytësore (mbetjet teknologjike).
3. Ofrimi i shërbimi doganor në pikat e kalimit të kufirit edhe pas orarit zyrtar.
4. Eliminimi i vonesave në rimbursimin e TVSH-së.
5. Qartësimi dhe lehtësimi i procedurave të regjistrimit të biznesit (miratimi i heshtur).
6. Rinovimi vjetor i autorizimit për konsumin e karburanteve.
7. Pajisja me certifikatë EURO-1, si certifikatë e origjinës së prodhimit shqiptar, për të gjithë mallrat e gatshëm që eksportohen nga subjektet fasoniste që operojnë në Shqipëri duke iu referuar standardeve europiane.
8. Përfaqësim politik i industrisë fason në organet vendimmarrëse për problematikat e këtij sektori.
9. Forcimi i kapaciteteve institucionale të lidhura me hartimin e politikave mbështetëse për këtë sektor (krijimi i një agjencie, angazhimi i një personi kontakti, promovim i imazhit)
10. Lehtësi fiskale dhe mbështetje buxhetore nga ana e shtetit për sigurimet shoqërore e shëndetësore për vendet e reja të punës.
11. Thjeshtimi i procedurave në Zyrat e Punës.
12. Krijimi i një show room –i për rritjen e aksesit në tregjet ndërkombëtare. Promovimi i sektorit në tregun vendas dhe ndërkombëtar).
13. Mungesë e atashëve tregtar me qëllim marketing agresiv në tregun ndërkombëtar.
14. Stimulimi i një zone industriale pilot dhe promovimi i cluster-ave si mënyrë e re për tërheqjen e investimeve të huaja dhe rritjen e produktivitetit
15. Mbështetje financiare për pjesëmarrje në panaire dhe ekspozita ndërkombëtare.
16. Asistencë financiare/teknike për zhvillimin e teknologjisë (informacion mbi tregun, teknologjinë dhe konkurrueshmërinë e sektorit).

17. Zgjerimi i listës së makinerive dhe pajisjeve që përjashtohen nga TVSH.
18. Rishikimi i tatim-fitimit i cili konsiderohet shumë i lartë.
19. Eliminimi i taksës së transportit për mjetet shqiptare drejt Italisë dhe mjeteve me targa italiane që transportojnë për llogari të subjekteve fasoniste drejt Shqipërisë.
20. Rritje e efikasitetit për kujdesin shëndetësor (raportet mjekësore për të punësuarit të bëhen një herë në 2 vjet, nga një herë në 6 muaj që është aktualisht).
21. Nënkontraktorët të kenë trajtim të njëjtë me kontraktorin kryesor sa i përket rimbursimit të TVSH-së (shkarkimi i TVSH-së tek nënkontraktorët).
22. Krijimi i fondeve të veçanta për ndarjen e risqeve dhe burimeve financiare me donatorët për zhvillimin e eksporteve.
23. Lidhje automatike e të dhënave në një sistem online ndërmjet tatimeve dhe sigurimeve shoqërore.
24. Krijimi i qendrave të trajnimit të kualifikuar dhe kurrikulave për nevoja të kësaj industrie.
25. Ngritja e qendrave profesionale
26. Rishikimi i taksave dhe tarifave vendore për terrenet dhe godinat, ku zhvillohet aktiviteti fason me qëllim që të kategorizohen me tarifë më të ulët ose në çmimin dysheme .
27. Falje të kamatë-vonesave për mospagim të sigurimeve shoqërore për periudhën 1 Janar 2008 – 31 Mars 2014.
28. Të përdoren marzhe të koeficienteve të shfrytëzimit të materialit të përdorur si lëndë e parë, bazuar në kodin doganor të BE-së.
29. Zgjdhje e problemit të gjobave doganore për diferencën në peshë. Të përdoret si kriter referues sasia e produktit final të porositur, siç rezulton nga dokumentacioni doganor.
30. Rinovim automatik në heshtje i autorizimit për përpunimin aktiv të mallrave.
31. Procedurat e import/eksportit të mallrave të kryen në pikën e zgjedhur nga subjektet tregtare.
32. Autorizimet për makineritë që ndodhen nën regjimin e përkohshëm të përpunimit aktiv të mos jenë 1+1 vit, por të jenë 5 vjeçare dhe të jepen pranë Degëve Doganore.

NISMAT E NDËRMARRA NGA QEVERIA

» **1** Është miratuar VKM nr. 54 datë 5.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore";

» **1.1** Është miratuar Udhëzimi "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasur-

Efekti për industrinë

- Për herë të parë parashikohet kontratë qiraje me tarifën simbolike 1 €/kontrata për industrinë e fasonit.
- Impakti financiar përlllogaritet rreth 24 mln lekë/vit që i mbeten biznesit fason.

» **2** Është miratuar Udhëzimi nr. 1/1, datë 29.01.2014 "Për disa shtesa në Udhëzimin nr.01, datë 06.09.2012, "Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv", neni 9, pika 2.2.1.

Efekti për industrinë

- Ulja e kostos administrative dhe shkurtim i kohës për operatorët ekonomikë

» **3** Është miratuar Urdhri në zbatim të VKM nr. 205, datë 13.04.1999 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", Kreu 4, Neni 14 "Orari i punës së zyrave doganore".

Efekti për industrinë

- Mundësi për deklarim dhe kontroll edhe pas përfundimit të orarit zyrtar.
- Shkurtim i kohës për biznesin

» 4 Është miratuar Ligji nr. 179/2013 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

» 4.1 Është miratuar Udhëzimi nr.06 datë 27. 02.2014 "Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin nr.17, datë 13.05.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar".

» 4.2 Është miratuar VKM nr. 202, datë 09.04.2014 "Për përcaktimin e kush-

Efekti për industrinë

- Tashmë rimbursimi i TVSH-së përfitohet:
 - Menjëherë në rast se tatimpaguesi është eksportues me risk zero.
 - Brenda 30 ditëve në rast se tatimpaguesi është eksportues;
 - Brenda 60 ditëve në rastin e tatimpaguesve të tjerë.
- Rritje e likuiditetit me rreth 900 milion lekë për tatimpaguesit me marrjen e TVSH-së kreditore.

» 5 Do të rritet eficaenca e zbatimit të Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Efekti për industrinë

- Lehtësim dhe përmirësim i procedurave të regjistrimit përmes aplikimit online nëpërmjet portalit e-Albania.
- Shkurtimi i kohës së regjistrimit nga 1 ditë në 8 orë pune.
- Subjektet mund të aplikojnë për regjistrim nëpërmjet internetit pa qenë nevoja të paraqiten në sportelet e QKR-së nëpërmjet aplikimit të nënshkrimit elektronik.

Shërbimet që do të ofrohen online:

- Aplikimi online për "Regjistrim Fillestar";
 - Aplikimi online për rregjistrime të tjera të detyrueshme;
 - Shkarkimi i ekstrakteve nga e-Albania dhe shërbimet e tjera
 - Pranimi/Pezullimi/Refuzimi i aplikimit;
 - Aplikimi online për depozitimin e pasqyrave financiare dhe raporteve të auditit.
- Platforma do të mund të përdoret nga 20% e bizneseve brenda vitit 2014, 40% gjatë vitit 2015 dhe 50% gjatë vitit 2016.
 - Mundësimi i tërheqjes on-line të ekstrakteve apo dokumentave të tjera nga 30% e bizneseve brenda vitit 2014, 50% gjatë vitit 2015 dhe 2016.
 - Ulja e vizitave të bizneseve në QKR me 50% në qendër dhe 50 % në sportelet e rretheve.

» **6** Autorizimi i TVSH-së për karburantet është rregulluar me Udhëzimin Nr 6/3 datë 08.04.2014 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.17, datë 13.05.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar""

Efekti për industrinë

- TVSH e karburantit kreditohet menjëherë pa pasur nevojë për të dorëzuar dokumente apo për miratim nga Drejtoritë Rajonale Tatimore
- Reduktim i kohës dhe kostove për biznesin

» **7** Kushtet për dhënien e origjinës preferenciale të mallrave përcaktohen nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) dhe Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë, si CEFTA, EFTA etj

Efekti për industrinë

- Bizneset që aplikojnë mund të pajisen menjëherë me çertifikatën EURO-1 nëse përmbushin kriteret e përcaktuara.

» **8** Shoqatat e Industrisë së fasonit bazuar në parimin e rotacionit do të përfaqësohen në Këshillin Ekonomik Kombëtar.

Efekti për industrinë

- Krijë e dialogut aktiv me Qeverinë.

» **9** Është marrë angazhimi për fuqizimin e rolit të AIDA-s në mbështetje të industrisë;

» **9.1** Është vendosur ngritja e një sporteli "One Stop Shop" të dedikuar për industrinë fason pranë AIDA-s;

Efekti për industrinë

- Mbështetje financiare për të paktën gjashtë sipërmarrje fason nëpërmjet skemave grant që administrohen nga AIDA, me një vlerë prej 10,8 mln lekë ose 34% të totalit të granteve;
- Ndërmjetësim për zgjidhjen e problematikave që do të adresohen pranë sportelit;
- Ndjekje dhe monitorim në terren i problematikave dhe impaktit të paketës lehtësuese nëpërmjet takimeve periodike;
- Krijimi i data-bazës për këtë industri;
- Përmirësim i imazhit të sipërmarrësve fason nëpërmjet faqeve ëeb të dedikuara.;
- Konferencë vjetore për fasonët nga AIDA

10 U miratuan ndryshimet

- » VKM Nr. 193, datë 2.4.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.47, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave, “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, të ndryshuar”;
- » VKM Nr. 192, datë 2.4.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.48, datë 16.1.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papunë në vështirësi”, të ndryshuar”;
- » VKM Nr. 188, datë 2.4.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.199, datë 11.1.2012 të Këshillit të Ministrave “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papunë, që hyjnë për herë të parë në punë”;
- » VKM Nr.189, datë 2.4.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.27, datë 11.1.2012 të Këshillit të Ministrave “Për programin e nxitjes së

Efekti për industrinë

- Vlera e programeve për nxitjen e punësimit përlllogaritet 100 mln lekë ose 3-fish rritje krahasuar me vitin 2013;
- 1 vit sigurime shoqërore
- 4 paga të mbuluara nga shteti për kategoritë e parashikuara në VKM-të përkatëse.
- Për nxitjen e punësimit nëpërmjet formimit në punë shteti financon
 - 70% të kostove të trajnimit për SME-të
 - 50% për ndërmarrjet e mëdha.

- » 11 Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ka thjeshtuar procedurat në Zyrat e Punës

Efekti për industrinë

- Shkurtim procedurash si rrjedhojë e eliminimit të Inspektoriatit Shtetëror të Punës në procesin e miratimit;
- Aplikimi online nga subjektet www.puna.gov.al;
- Vlerësimi i performancës me bazë pikëzimi për miratimin e projekteve
- Shkurtim i afateve të miratimit të projekteve nga 30 e 20 ditë në 10 ditë;
- Akses i shpejtë në të dhëna përmes bankës së të dhënave online për punëdhënësit dhe punëkërkesit

» **12** Do të ngrihet një show room me financimin e donatorëve si: GIZ/EDEP (Programi për Zhvillimin e Ndërmarrjeve dhe Punësimin), Kooperacioni Italian dhe USAID etj.

Efekti për industrinë

- Mbështetje me asistencë teknike dhe logjistike për krijimin e modelit të show room.

» **13** Ka nisur procesi për forcimin e rolit të diplomacisë ekonomike përmes ngritjes së strukturës së Atasheve Tregtarë, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme

Efekti për industrinë

- Promovim i markës MADE IN ALBANIA;
- Promovim i imazhit të vendit;
- Rritje të pjesëmarrjes në network-un e gjerë të ndërmarrjeve europiane.

» **14** Po rishikohet legjislacioni për funksionimin e zonave ekonomike si dhe problematikat për secilën zonë të shpallur me vendimet përkatëse.

Efekti për industrinë

- Rritja e mundësive për akses

» **15** Po rishikohet VKM Nr. 419, datë 15.5.2013, "Për krijimin e fondit shqiptar të konkurrueshmërisë".

Efekti për industrinë

- Rritje me 40% e vlerës për projekt me një shumë prej 1,400.000 lekë;
- Bizneset mund të aplikojnë më shumë se 1 herë nga ky Fond;
- Rritje e pjesëmarrjes së kompanive në panairë dhe ekspozita ndërkombëtare;



- » **16** Po negociohet për sigurimin e fondeve nga:
- Marrëveshjet për programe financiare nga donatorë si Koopera-
cioni Italian & KFW (me një vlerë prej 39 mln EURO).

Efekti për industrinë

- Lehtësi për financimin e bizneseve për investimet në teknologji me kredi të butë për importin e linjave teknologjike me interesa më të ulta se ato të tregut.

- » **17** Në proces rishikimi VKM-ja nr. 180, datë 13.2.2013 “Për përcaktimin e listës së makinerive e të pajisjeve që janë drejtpërdrejt të lidhura me investimin dhe të procedurave të përjashtimeve e të kriterëve përkatëse”, e ndryshuar.

Efekti për industrinë

- Përjashtim nga TVSH për makineritë dhe pajisjet;
- Impakti financiar përlloraget në rreth 150 milion lekë që i mbeten biznesit.

- » **18** Rikthimi i tatim fitimit të industrisë fason do të realizohet përmes rialo-
kimit në një Fond të veçantë për Punësim dhe Aftësim në MMSR.

Efekti për industrinë

- Fondi për Punësim dhe Aftësim përlloraget në vlerën 5 milionë dollarë për vitin e parë që do të bëhet në mënyrë graduale;
- Nxitje e punësimit dhe kualifikimit të forcës së punës.

- » **19** Po konsultohet nënshkrimi i një Marrëveshjeje me Qeverinë Italiane për heqjen e taksës fikse të transportit.

Efekti për industrinë

- Reduktimi i kostove aktuale 6,2 €/ ton, për 100 km.



» **20** Po rishikohet Rregullorja në zbatim të VKM-së nr.100, datë 03.02.2008 "Për përcaktimin e substancave të rrezikshme"

Efekti për industrinë

- Reduktimi i kohës dhe kostove për industritë që klasifikohen me rrezikshmëri të ulët për shëndetin e punëmarrësve.

» **21** Është hartuar Draft-Ligji "Për TVSH-në" i cili parashikohet të hyjë në fuqi më 1 Janar 2015.

Efekti për industrinë

- Reduktim i kostove të TVSH-së për nënkontraktorët që përlllogariten rreth 760 mln lekë

» **22** Do të sigurohet pjesëmarrja/aplikimi në programet komunitare dhe rajonale si: COSME, EDIF etj.

Efekti për industrinë

- Stimulim i Industrisë së Fasonit nëpërmjet sigurimit të asistencës teknike ose financiare.

» **23** Ka nisur projekti për sistemin e lidhjes online (single window) të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me atë të Sigurimeve Shoqërore.

Efekti për industrinë

- Reduktim i kohës për vajtjen nga një zyrë në tjetrën.
- Reduktim i kostove për dokumentacionin.

» **24/25** Janë hartuar në kuadër të kualifikimit dhe formimit profesional:

- Projekti ADA "Për Zhvillimin e Sistemit Dual në Shqipëri" në bashkëpunim me "Naber Damen Mode" me një kosto prej 390,000 Euro, për ngritjen e tre shkollave në tre qytete të vendit

- Hapja e një kursi post-sekondar pranë Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike (dega tekstile);

- Projekti i BE-së dhe ILO Për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore (IPA-ILO 2010, HRD)

Efekti për industrinë

- Përmirësim i aftësive të punëmarrësve;
- Hapja e një kursi të formimit profesional në fushën e tekstitit;
- Çertifikimi i njohurive të fituara jashtë shkolle (është zgjedhur si pilot industria e tekstitit).

» **26** Në proces rishikimi i Ligjit Nr. 181/2013 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar

Efekti për industrinë

- Krijimi i instrumenteve të mirë-administrimit të kësaj takse, ndryshimi i modelit të taksimit, nga lek/m² në % ndaj vlerës së tregut.

» **27** Ministria e Financave do të hartojë Ligjin për faljen e kamatë vonesave për sigurimet shoqërore për industrinë e fasonit.

Efekti për industrinë

- Impakti financiar përlogaritet rreth 100 milion lekë.

» **28** Neni 140 i Kodit Doganor specifikon koeficientin e shfrytëzimit. Draft-Kodi i ri Doganor përafron plotësisht dispozitat lidhur me këtë regjim.

Efekti për industrinë

- Lehtësim i procedurave doganore.



» 29 Gjobitja e bizneseve për shkak të diferencës në peshë po shqyrtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për t'u adresuar nëpërmjet Draft-Kodit të ri doganor.

Efekti për industrinë

- Lehtësim i procedurave doganore.

» 30 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave po punon për ta reflektuar këtë problematikë në Draft-Kodin e ri doganor.

Efekti për industrinë

- Ulje e kostove financiare dhe kohës për biznesin

» 31 Bazuar në legjislacionin doganor, çdo mall që deklarohet në regjimet doganore ekonomike përjashtohet nga rregulli i kompetencës territoriale. E drejta për vendosjen në regjim mundësohet në çdo zyrë doganore. Autoriteti Doganor Shqiptar është në një proces përgatitje për ngritjen e infrastrukturës ligjore, IT dhe kualifikim stafi për implementimin e procedurave të thjeshtuara.

Efekti për industrinë

- Lehtësim i procedurave administrative
- Reduktim i kohës për bizneset.

» 32 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave po shqyrton procedurat për t'i dhënë zgjidhje kërkesës për autorizimin 5-vjeçar

Efekti për industrinë

- Lehtësim i procedurave administrative
- Reduktim i kohës për bizneset





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES**

**TIRANE
Prill 2014**